



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.24, datë 15.02.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Z. Durim Bedini**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
2. **Z. Durim Bedini**, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë nga data 18.02.2022 – 17.05.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, z. Durim Bedini do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
4. Të njoftohen për këtë vendim z. Durim Bedini, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR
ALFRED BAJLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
TARTAR BAZAJ